VENDIM
Nr. 510, datë 27.7.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "PROJEKTIMI I SHKOLLËS SË BIÇIKLETAVE PËR GRUP-MOSHAT 7–10 VJEÇ, TIRANË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Projektimi i Shkollës së Biçikletave për grup-moshat 7-10 vjeç, Tiranë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 399 239 042 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyzet e dy) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 399 239 042 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyzet e dy) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Tiranë.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.
8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Tiranë.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PROJEKTIMI I SHKOLLËS SË BIÇIKLETAVE PËR GRUP-MOSHAT 7–10 VJEÇ, TIRANE

Nr.	Pronari			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe e shpronësuar	Çmimi lekë/m^2	Vlera totale (lek)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Arben Selami Hoxha Ariana Nestor Nepravishta Armand Tartari Dorian Nestor Nepravishta Faslli Abedin Nepravishta Fatbardh Nepravishta Rezar Tartari Uran Tartari Vera Bajram Nepravishta			8160	6/440	692.55	Truall	692.55	66,969	**46,379,381**	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Liljana Nikolla, Jahmir Gani Hyka, Luan Fetah Rama, Denis Naim Matoshi, Armand Grori, Dorian Grori, Irid Kotoni, Erjon Besnik Rama,Ylber Shaban Grori, Ramazan Shaban Grori, Osman Ismail Dervishi, Suzana Selman Grori, Majlinda Selman Pina, Alma Selman Grori, Saimir Selman Grori, Agron Ismail Dervishi, Artur Ramis Shehu, Erida Agim Asllani, Blerim Gani Hyka, Andi Ramazan Grori, Global Construction, Oriada Latif Abazaj, Elton Gjergji Mehmeti, Endi Rama, Fatbardha Ismail Dervishi Greta Grori, Jolanda Jonuz Grori, Myzejen Rama, Xhelal Karaj, Xhesika Rrok Dodaj			8160	6/438	5269	Truall	5269	66,969	**352,859,661**	Vendoset sekuestro shkresa nr. 3116 prot., datë 12.11.2021, prot. 10027 datë 17.11.2021. Pjesa takuese 2163/30000 në pronësi të Denis Matoshit. Vendimi 29, datë 2021 vendoset sekuestro shkresa nr. 3116 prot. datë 12.11.2021 prot. 10027, datë 17.11.2021. Pjesa takuese 2163/30000 në pronësi të Denis Matoshit. Vendimi 29, datë 7.11.2021. Depozituar K. SIP, me shoq. A&A CONSTRUCTION nr. 1163/357, datë 4.11.2020, nr. 999/327, datë 21.10.2020, nr. 1065/334, datë 27.10.2021, nr. 1229/376 + nr. 1228/376, datë 20.11.2020, nr. 1052/332, datë 24.10.2020, nr. 1224/371, datë 19.11.2020, nr. 993/325, datë 20.10.2020, nr. 998/326, datë 21.10.2020, nr. 1227/374, datë 20.11.2020
Vlera										**399,239,042**	